



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 27.6.2022

- Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 8.9.2021, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve me shkrim, të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 20.6.2022, zhvilluar në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se:

1. *Lidhur me saktësinë e deklaramit të likuiditeteve cash*, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i akteve të administruara në fashikull gjatë hetimit administrativ, vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket vlerës së *cash*-it jashtë sistemit bankar ndër vite apo dinamikës së përdorimit të tyre për të mbuluar shpenzime të caktuara, nuk përputhen me sa është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore, duke mbetur kështu në nivel deklarativ dhe të pambështetura në prova.

1.1 Për më tepër, në parashtrimet e paraqitura në seancën e datës 20.6.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një alternativë tjetër lidhur me shtesat dhe pakësimet e likuiditeteve *cash* ndër vite¹, që është e ndryshme nga sa është deklaruar më parë nga subjekti. Në këtë pretendim të ri nuk pasqyrohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016, ku

¹ Referohuni tabelës në faqen nr. 12, të parashtrimeve.

deklarohet se janë pakësuar kursimet *cash*, në shumën 600.000 lekë, në vitin 2013, si dhe janë pakësuar kursimet *cash* të bashkëshortit të subjektit, në shumën 800.000 lekë, në vitin 2014.

1.2 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash*, duke pamundësuar kështu dhe verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të rrjedhura prej tyre.

2. Në lidhje me mjaftueshmërinë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 4.000.000 lekë. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 8.9.2021², vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve *cash*, të deklaruara nga personi i lidhur në DV-2013, për të cilat ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme në krijimin e tyre në vlerën - 1.648.646 lekë.

2.1 Ashtu sikurse është trajtuar në ankimin e paraqitur dhe në parashtrimet e dhëna në seancën gjyqësore të datës 20.6.2022, këto kursime *cash* kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë: (i) *Automjeti tip Mercedes-Benz, me targa: ****; (ii) *Llogari bankare në *** Bank, në shumën 1.300.000 lekë*; (iii) *Llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, në *** Bank, me balancë në datën 31.12.2016, në shumën 1.774.148,61 lekë* dhe (iv) *Llogari bankare në *** Bank, në shumën 1.505,1 euro*.

2.2 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë likuiditete *cash*, deklaruara në DV- 2013, pasi nuk arrin të provojë plotësisht burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Për rrjedhojë, kjo situatë faktike lidhur me ligjshmërinë e burimit konstatohet edhe për pasuritë e krijuara nga këto kursime, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

3. Për pasurinë *Automjet tip Mercedes-Benz, me targa: ****, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën, lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për mbulimin me burime të ligjshme të krijimit të këtij asemi, më së paku, në vlerën - 352.255 lekë³, duke u ndodhur në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në referencë të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

4. Duke përfunduar për sa parashtruam, Komisioneri Publik dëshiron të ritheksojë, edhe njëherë, se për rastin objekt gjykimi, mbështetur edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshim nga Komisioni lidhur me arsyetimin dhe gjetjen zbatim të parimit të “proporcionalitetit” në raport me kontradiksonin, pasaktësitë dhe pamjaftueshmërinë e konstatuar të ligjshmërisë së burimit të krijimit të

² Referohuni Rekomandimit të ONM-së, prg. A) 1, 2, 3, 4, 5.

³ Nga analiza ekonomike e Komisionit, deri në datën e blerjes së këtij automjeti (**.4.2014), ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën – 1.386.783 lekë, ndërsa në konsideratë të pretendimeve të subjektit se gjendja *cash* ka ndryshuar gjatë vitit, nga analiza financiare vjetore për vitin 2014, është konstatuar një pamjaftueshmëri në vlerën - 352.255 lekë.

likuiditeteve *cash* dhe pasuritë e rrjedhura prej tyre, duke i qëndruar kështu shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të dhëna në seancë gjyqësore.

Kërkimi përfundimtar i ankimit

5. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO